

Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës në bazë të nenit 28 dhe nenit 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 145/10, 136/11, 41/2014, 41/2014, 53/16 dhe 83/18), si dhe duke vepruar sipas njoftimit për përqendrim të parashtruar nga Mercedes-Benz Group AG Mercedesstrase 120. 70 372 Shtutgart, Gjermani (Mercedesstraße 120, 70372 Stuttgart, Germany), , përmes personit të autorizuar Martin Ivanov, avokatë nga Shkupi, në seancën e mbajtur më 23.03.2022, merr këtë:

### **AKTVENDIM**

Vërtetohet se përqendrimi që i referohet transferimit të aktivitetit të biznesit të Koresë së Jugut për furgonët nga marka Mercedes-Benz të shoqërisë Daimler Trucks Korea Ltd, me seli të regjistruar në katin e 8-të, Sheshi Seul, 416, Hangang-daero, Jung-gu, Seul 04637, Koreja e Jugut(8th Floor, Seul Sauare, 416, Hanaanaa-Daero, Juna-au, Seul 04637, South Korea), të shoqërisë Mercedes-Benz Koreja Limited, me adresë të regjistruar në katin e 9-të, Sheshi Seul, 416, Hangang-daero, Jung-gu, Seul 04637, Koreja e Jugut(9th Floor, Seul Sauare, 416, Hanaanaa-Daero, Juna-au, Seul 04637, South Korea), pjesë e Mercedes-Benz Group AG, edhe pse është në kuadër të dispozitave të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës, nuk do të ketë për pasojë parandalimin, kufizimin ose çrregullimin e konsiderueshëm të konkurrencës efektive të tregut ose pjesës së tij thelbësore, sidomos si rezultat i formimit apo forcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve dhe si i tillë **është në përputhje me dispozitat e Ligjit të mbrojtjes së konkurrencës në kuptim të nenit 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës.**

Parashtruesi i njoftimit për përqendrim obligohet që për njoftimin për përqendrim të paguaj taksë administrative në shumë prej 6.000,00 denarë. dhe për aktvendimin në shumën prej 30.000,00 denarë, sipas numrit tarifor 34 të Ligjit për taksa administrative ( Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 17/93, 20/96, 7/98, 13/01, 24/03, 19/04, 61/04 dhe 95/05, 7/06, 70/06, 92/07, 88/08, 130/08, 6/10, 145/10. 17/11) në llogarinë e Buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 100000000063095, llogarinë e pagesës 840.....03161, shifrën e të ardhurave dhe programin 72231300.

Padia për ngritjen e kontestit administrativ nuk e prolongon përmbardimin e aktvendimit.

## Arsyetim

Në përputhje të nenit 15 të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, më 25.02.2022, ndërsa plotësuar më 28.02.2022, deri te Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës (në tekstin e mëtejshëm: Komisioni) u dorëzua një njoftim për përqendrim nga Mercedes-Benz Group AG Mercedesstrase 120. 70 372 Shtuttgart, Gjermani (*Mercedesstraße 120, 70372 Stuttgart, Germany*), që i referohet transferimit të aktivitetit të biznesit të Koresë së Jugut për furgonët nga marka Mercedes-Benz të shoqërisë Daimler Trucks Korea Ltd, me seli të regjistruar në katin e 8-të, Sheshi Seul, 416, Hangang-daero, Jung-gu, Seul 04637, Koreja e Jugut (*8th Floor, Seul Square, 416, Hanaanaa-Daero, Juna-au, Seul 04637, South Korea*), të shoqërisë Mercedes-Benz Koreja Limited, me adresë të regjistruar në katin e 9-të, Sheshi Seul, 416, Hangang-daero, Jung-gu, Seul 04637, Koreja e Jugut (*9th Floor, Seul Square, 416, Hanaanaa-Daero, Juna-au, Seul 04637, South Korea*), pjesë e Mercedes-Benz Group AG.

Komisioni filloi shqyrtimin e Njoftimit nga dita e pranimit të tij dhe në bazën e të dhënave të paraqitura në Njoftimin për përqendrim, shtojcat dhe anekset e tyre, konstatoi si në vijim:

Përqendrimi i referohet konkretisht riorganizimit global të asaj që më parë ishte Grupi Daimler (*Daimler Group*), i udhëhequr nga shoqëria Daimler AG, tash e quajtur Mercedes-Benz Group AG.

Mercedes-Benz Group AG- aktivitetin e saj afarist e ndau për kamionë dhe autobusë në një grup të pavarur të korporatave, tash të udhëhequr nga Daimler Trak Holding AG, me një adresë afariste të udhëhequr në Fasanenveg 10, 70771 Lajnfwlden-Ehterdingen, Gjermani (*Fasanenwea 10, 70771 Leinfelden-Echterdinaen, Germany*), sipas të cilit Mercedes-Benz Group AG dhe Daimler Trak Holding AG, janë tash dy subjekte të pavarura ndër të tjera në kuptim të rregullave për kontroll të përqendrimeve.

Sepse të gjitha hapat e riorganizimit global nuk mund të kishin ndodhur në kohë për Spin-ofot më 9 dhjetor 2021 dhe kuotim të njëpasnjëshëm të aksioneve të Daimler Trak Holding AG në 10 dhjetor 2021, disa transaksione të mëtejshme ndërmjet Mercedes-Benz Group AG dhe Daimler Trak Holding AG, ishin të nevojshëm për të kryer ndarja e këtyre grupeve të korporatave.

### **Aktivitetet themelore të biznesit të ndërmarrjeve të përfshira:**

#### **Mercedes-Benz Koreja Limited është pjesë e Mercedes-Benz Group AG.**

**Mercedes-Benz Group AG** është një korporatë aksionare e kuotuar publikisht, e themeluar sipas ligjeve të Gjermanisë, me seli në Shtuttgart, Gjermani. Ajo është një shoqëri mëmë e Grupit Mercedes-Benz e cila zhvillon, prodhon dhe shpërndan prodhime automobilistike, kryesisht makina pasagjerësh dhe furgona, dhe ofron shërbime financiare dhe të mobilitetit në nivel global.

Para Spin-ofot, Mercedes-Benz Group AG ishte shoqëri mëmë e asaj që do të ishte Grupi Daimler, e organizuar në tri divizione dhe e udhëhequr nga ndërmarrjet e Mercedes-Benz Group AG në pronësinë e saj të plotë: (1) Mercedes-Benz AG, që menaxhonte me aktivitetin e biznesit për makinat e pasagjereve dhe furgonat e Grupit; (2) Daimler Trak AG- menaxhonte aktivitetin e kamionëve dhe autobusëve të Grupit; (3) Daimler Mobility AG- e cila, ndër të tjera, mbështeti shitjet e markave të Grupit me shërbime të përshtatshme për mobilitet dhe shërbime financiare në mbarë botën.

Mercedes-Benz AG menaxhon aktivitetin e biznesit për makina dhe furgona nën markat Mercedes-Benz dhe smart. Mercedes-Benz AG është e ndarë në divizione Mercedes-Benz Cars dhe Mercedes-Benz Vans.

Mercedes-Benz Cars ofron makina duke filluar nga makinat kompakte deri te makinat premium. Marka Mercedes-Benz u plotësua me nën-markat Mercedes-EO, Mercedes-AMG, Mercedes-Maybach.

Mercedes-Benz Vans është një furnizues global i portofolit të furgonave dhe shërbimeve të ngjashme, duke filluar me furgona të mëdhenj nga marka Sprinter përmes furgonave me madhësi mesatare të markës Vito dhe furgonave për dërgesë urbane nga marka Citan deri te furgonat me kampistë.

Daimler Mobility AG mbështet shitjet e markave të automobilave të Grupit në mbarë botën me shërbime të përshtatshme për mobilitet dhe shërbime financiare. Markat kryesore të Daimler Mobility janë Mercedes-Benz Banka, Mercedes-Benz Financial Services dhe Athlon.

Daimler Traks Korea Ltd. është distributor i furgonave të markave Mercedes-Benz në Korenë e Jugut. Aktivitetet e saj të biznesit lidhur me furgonat do të transferohen te Mercedes-Benz Group AG në formën e një transaksioni që përfshinë mjetet e shoqërisë.

Komisioni konstatoi se përqendrimi i parashtruar bie nën dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, sepse i plotëson kushtet e nenit 12 paragrafi (1) pika 2) dhe nenit 14 paragrafi (1) pika 1 dhe pika 2)) të Ligjit për Mbrojtje të Konkurrencës.

Komisioni, duke marrë parasysh kriteret e nenit 17 paragrafi (2), paragrafi (3) dhe paragrafi (4) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës dhe pikën 6 (b) të *Udhëzimeve për përcaktimin e rasteve në të cilat gjatë vlerësimit të përqendrimeve, Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës zakonisht përcakton se të njëjtat janë në përputhje me Ligjin për mbrojtjen e konkurrencës*, vlerëson se përqendrimi i parashtruar, edhe pse bie nën dispozitat e Ligjit, është në përputhje me të, sepse nuk do ketë në masë të konsiderueshme pengimin, kufizimin ose prishjen e konkurrencës efektive të tregut ose të pjesës qenësore të tij, veçanërisht si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve

Duke pasur parasysh këtë vlerësim të përqendrimit, Komisioni vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi, në përputhje me nenin 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës.

Sipas Nenit 53 paragrafi (2) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës padia nuk e prolongon zbatimin e aktvendimit.

### **Udhëzim për mjetin juridik**

Kundër këtij aktvendimi mund të parashtrohet padi për inicim të kontestit administrativ në Gjykatën Administrative të Republikës së Maqedonisë në afat prej 30 ditësh nga dita e dorëzimit të tij.

**KRYETAR**

**I KOMISIONIT PËR MBROJTJEN E KONKURRENCËS**

**Prof. Dr. Владимир Наумовски**